



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 861/4 prot.

Tiranë më 19.8.2021

REKOMANDIM

Nr. 44, datë 19.8.2021

PËR KONTROLLUESIN “PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), relacionit të hetimit administrativ për përhapjen e paligjshme të të dhënave personale të shtetasve, datë 19.08.2021 (në vijim, “Relacioni i Hetimit Administrativ”), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Partia Socialiste e Shqipërisë” (në vijim, “Kontrolluesi” dhe/ose “PSSH”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 57, datë 05.05.2021 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ kryesisht, pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Verifikim lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale të shtetasve/zgjedhësve, nisur nga informacionet e publikuara në median elektronike, si dhe verifikimi i ankesave të paraqitura pranë Zyrës së Komisionerit.

Zyra e Komisionerit, bazuar në pikat 1.5 dhe 1.6 të Pjesës 1, si dhe Pjesën 2, të Relacionit të Hetimit Administrativ, si dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit, vëren se:

1. Referuar deklarimeve të përfaqësuesve, konstatimeve në vend, si dhe të dhënave të web-ndërfaqes online të listës së zgjedhësve që administron PSSH, rezulton se ky kontrollues disponon dy kategori baza të dhënash. Konkretisht, njëra konsiston në të dhënat e anëtarëve të partisë dhe e dyta konsiston në të dhënat e listës së zgjedhësve.

Të dyja bazat e të dhënave mund të aksesohen nga një web-ndërfaqe e vetme online. Web-ndërfaqja online është e pajisur me ‘emër përdoruesi’ dhe ‘fjalëkalim’ për çdo nivel përdoruesi.

Nga pikëpamja teknike, në nivel përdoruesi (në rastin konkret, për Bashkinë Tiranë), mund të aksesohen të dyja bazat e të dhënave, si ajo e anëtarëve, po ashtu edhe ajo e votuesve.

Serveri në të cilin është vendosur baza e të dhënave, të cilat aksesohen nëpërmjet web-ndërfaqes *online*, është e instaluar lokalisht, në selinë e Kontrolluesit.

Bazuar në formularin e anëtarësisë, të vënë në dispozicion gjatë hetimit pranë PSSH, kategoritë e të dhënave të anëtarësisë që përpunon ky kontrollues janë *“emër, atësi, mbiemër, vendlindje, datëlindje, gjini, numër personal identifikimi, arsim, punësim, data e pranimit në PSSH, numër celulari, e-mail, linku i Facebook, adresë banimi, numër qendre votimi, njësia bashkiake, bashkia”*.

Ndërsa kategoritë e të dhënave të listës së zgjedhësve, të cilët ushtrojnë të drejtën e tyre në një bashki të caktuar (në këtë rast, në Bashkinë Tiranë), sipas web-ndërfaqes *online* të Kontrolluesit, janë *“kodi i zgjedhësit, emër, atësi, mbiemër, qendër votimi, numër liste zgjedhore, kod banese, datëlindje, mosha, census (informacion në lidhje me bindjen politike), numër telefoni, anëtarësi, patronazhuesi”*.

Përfaqësuesit e Kontrolluesit deklaruan se kategoritë e të dhënave të zgjedhësve janë të dhënat e marra nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me kërkesë të përfaqësuesit ligjor të PSSH, të atashuar pranë këtij institucioni. Lista merret në format DVD dhe përditësohet në bazën qendrore të të dhënave të zgjedhësve. Të dhënat e tjera të shtuara, si numër telefoni dhe të dhëna preference (census), janë të dhëna të shtuara nga patronazhuesi.

Të dhënat në lidhje me preferencën politike (census) dhe numër telefoni, janë mbledhur nga sistemi ‘patronazhuesi’, referuar udhëzimit të brendshëm datë 11.01.2021, drejtuar strukturave të subjektit politik.

Sistemi ‘patronazhuesi’ është i përbërë nga anëtarët dhe simpatizantët e partisë. Patronazhuesve ju vihet në dispozicion lista e zgjedhësve që secili prej tyre ka në patronazh dhe detyra e tyre është përmbyllja e procesit të censusit dhe mbajtja e kontakteve me zgjedhësit në patronazh, deri në përfundim të votimit, si dhe kontaktimi i zgjedhësve për të përcjellë mesazhe elektorale, evidentimin e problemeve që lindin gjatë fushatës, etj.

2. Nga krahasimi i të dhënave që përpunon PSSH, bazuar në formularin e anëtarësisë në nivel vendi, me ato të një baze të dhënash objekt hetimi (data_tirana_2021_Backup_Backup.accdb), në të cilën rezultojnë të përpunuara të dhënat personale të 91 061 (*nëntëdhjetë e një mijë e gjashtëdhjetë e një*) subjekteve të të dhënave (në vijim, *“Baza e të Dhënave”*), rezulton se ato përputhen në 8 kategori të dhënash (*“emri, atësia, mbiemri, numri personal, datëlindja, vendlindja, numri i telefonit, qendra e votimit”*), si dhe kanë përafërsi në një kategori, në lidhje me

punësimin, e cila në Bazën e të Dhënave është e detajuar, ndërsa në bazën e të dhënave sipas formularit të anëtarësisë në PSSH është e natyrës së përgjithshme/gjenerike.

Në lidhje me këtë përpunim, Zyra e Komisionerit konstaton se të dhënat personale të përpunuara nëpërmjet plotësimit dhe nënshkrimit të formularit të anëtarësisë (në rang vendi), bazohen në pëlqimin e shprehur të anëtarit përkatës dhe kësisoj, *prima facie* nuk rezulton në kundërshtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, pasi ky përpunim bazohet në pëlqimin e shprehur të subjektit të të dhënave (germa “a” e pikës 1 të nenit 6 të Ligjit).

Të dhënat e përpunuara sipas rubrikave të formularit të anëtarësisë të PSSH popullojnë një bazë të dhënash (regjistrin e anëtarëve në rang vendi), e cila nuk rezulton e njëjtë me atë të Bazës së të Dhënave, qoftë nga perspektiva e formatit teknik, qoftë nga përmbajtja përkatëse. Rrjedhimisht, nga hetimi nuk rezultoi i mundur konstatimi i gjurmëve dhe/ose elementëve indikativë që mund të shpinin në dyshimin e arsyeshëm se kjo bazë të dhënash ka rrjedhur në mënyrë të paligjshme dhe është bërë publike duke u bashkëshoqëruar me të dhënat e tjera të Bazës së të Dhënave.

3. Nga ana tjetër, bazuar në deklaratimet e përfaqësuesve të PSSH, rezulton se:

“Formularët e anëtarësisë së partisë bëjnë pjesë në dokumentacionin e përhershëm të AS të bashkive dhe administrohen prej tyre. Përgjegjës për administrimin e tyre janë kryetari dhe sekretari organizativ i PS të bashkisë. Aksesin për të hyrë në regjistrin elektronik të partisë dhe për të bërë lëvizjet përkatëse (pranimet e reja, largimet nga partia, çregjistrimet, vdekjet, etj) e ka vetëm kryetari i partisë i bashkisë.”.

Kësisoj, të dhënat e përgjithshme të anëtarësisë, të plotësuara me kategoritë shtesë të të dhënave sipas listës së zgjedhësve (“kodi i banesës, censusi, patronazhuesi”), popullojnë një bazë të dhënash të natyrës *ad hoc*, e cila përdoret gjatë një fushate zgjedhore të caktuar.

Kjo bazë të dhënash rezulton të përkojë në 11 kategori të dhënash me ato të Bazës së të Dhënave. Konkretisht, “emri, atësia, mbiemri, numri personal, datëlindja, vendlindja, numri i telefonit, qendra e votimit, kod i banesës, censusi, patronazhuesi.”. Duke shtuar këtu edhe kategorinë e përafërt (“punësim – kompani”), numri total shkon në 12 kategori të dhënash, të cilat përbëjnë afërsisht 67% përputhshmëri.

Një tjetër element ngjashmërie lidhet me faktin se të dhënat e Bazës së të Dhënave rezultojnë të përmbajnë të dhënat e zgjedhësve në një territor të caktuar.

Faktet dhe rrethanat e hetimit administrativ nuk krijojnë kushtet për të evidentuar dhe provuar, në terma dhe hapa konkretë hetimorë, krijimin dhe përdorimin e Bazës së të

Dhënave nga asnjë subjekt hetimi administrativ. Por ngjashmëria e saj, në përmbajtje dhe territor, me të dhënat e përftueshme nga kombinimi i listës së anëtarësisë së PSSH në rang vendi, me të dhënat e listës së zgjedhësve të një territori të caktuar (e cila përmban, ndër të tjera, edhe përbërës zgjedhorë që origjinojnë nga të dhënat që DPGJC dhe KQZ vënë në dispozicion të subjekteve zgjedhore, në përputhje me nenin 60 të Kodit Zgjedhor), nuk e përjashton mundësinë që Baza e të Dhënave të jetë krijuar dhe përdorur nga nivele lokale organizimi politiko-zgjedhor dhe/ose organizime apo struktura të kandidatëve të veçantë (apo subjekteve të kontraktuar/nëkontraktuar prej tyre për ofrim shërbimesh në kuadër të fushatës zgjedhore dhe jo vetëm), në kundërshtim edhe me vetë rregullat e brendshme të organizimit të këtij Kontrolluesi.

Mosekzistenca e një baze të dhënash, të ngjashme me Bazën e të Dhënave, në asnjë territor tjetër të organizimit politik të PSSH në vend, përjashton këtë kontrollues nga dyshimi për autorësinë në krijimin dhe administrimin e Bazës së të Dhënave.

Por, nga ana tjetër, meqenëse në Bazën e të Dhënave ekzistojnë edhe të dhëna të anëtarëve të këtij subjekti politik, përpunimi origjinar i të cilave është realizuar me vullnetin e tyre, bartja dhe administrimi i këtyre të dhënave në Bazën e të Dhënave nënkupton një përdorim të paautorizuar të tyre nga persona që mund të kenë patur akses në to, në tejkalim të qëllimit të përpunimit.

Rrjedhimisht, Zyra e Komisionerit konstaton se mund të kemi të bëjmë me mungesë të masave tekniko-organizative për të garantuar sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave të anëtarëve të PSSH, të cilat rezultojnë të përpunuara edhe në Bazën e të Dhënave. Veçanërisht problematike është mungesa e sistemit të gjurmueshmërisë së aksesit në të dhënat personale të përpunuara prej këtij Kontrolluesi, si dhe qarkullimit të tyre.

4. Kontrolluesi ndërvepron me subjektet e të dhënave nëpërmjet faqes së internetit www.ps.al.

Në këtë faqe interneti janë parashikuar disa mënyra kontaktimi, ndër të tjera, nëpërmjet rubrikave të tilla si ‘*Na kontakto*’ dhe ‘*Rekomando shokun tënd*’.

Në të dyja rubrikat, në mënyrë që të përcillen të dhënat përkatëse është e nevojshme që dërguesi të japë pëlqimin e tij, duke klikuar më parë butonin e caktuar, i cili informon atë si vijon: “*Duke përdorur këtë website dhe këtë formular, ju bini dakord që të dhënat tuaja personale të përdoren për qëllime komunikimi gjatë fushatës tonë elektorale*”.

Gjithashtu, rubrika ‘*Rekomando shokun tënd*’ ka për qëllim rekomandimin e një personi të tretë (i cili mund të jetë ose jo, anëtar i PSSH), duke vendosur të dhënat personale si “*emër, mbiemër, e-mail dhe numër telefoni*”.

Sa më sipër, rezulton se www.ps.al ka mundësuar një mekanizëm të tillë, i cili – *a priori* – mbledh të dhëna personale, pa pëlqimin e shprehur të subjektit përkatës të të dhënave.

Zyra e Komisionerit vlerëson se përdorimi i rubrikës ‘*Rekomando shokun tënd*’ në faqen e internetit www.ps.al, bart elementë problematikë sa i përket ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave nëpërmjet këtij mekanizmi. Përpunimi i të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, për qëllime të organizimit politik, duhet realizuar në përputhje me parimet e parashikuara në nenin 5 dhe kriteret e ligjshmërisë të parashikuara në nenin 6 të Ligjit.

Për këtë qëllim, Zyra e Komisionerit ka miratuar dhe publikuar Udhëzimin nr. 35, datë 07.05.2013, “*Për përpunimin e të dhënave personale për qëllime të fushatës zgjedhore*” (në vijim, “*Udhëzimi nr. 35*”), i cili synon të adresojë përpunimin e të dhënave personale nga kandidatët e subjekteve politike gjatë një fushate zgjedhore.

Pavarësisht se Udhëzimi nr. 35 nuk adreson konkretisht përpunimin e të dhënave nga subjektet politike, por vetëm nga kandidatët përkatës, ai përbën një bazë të arsyeshme për zbërthimin, interpretimin dhe zbatimin e drejtë dhe korrekt të dispozitave të neneve 5 dhe 6 të Ligjit në kuadër të veprimtarive përpunuese për qëllime të organizimit dhe mbarëvajtjes së një fushate zgjedhore.

Në këtë kontekst, pika 1 e nenit 3 të Udhëzimit nr. 35 detyron Kontrolluesin të informojë qartësisht subjektet e të dhënave për qëllimin e mbledhjes së të dhënave personale dhe për mënyrën e përdorimit të tyre.

Udhëzimi nr. 35 parashikon, gjithashtu, kriterin ligjor të pëlqimit, si një element thelbësor në rast përpunimi të të dhënave sensitive, referuar pikës 2 të nenit 6 të tij.

Sa më sipër, përdorimi i rubrikës ‘*Rekomando shokun tënd*’ rezulton tejet problematik dhe i paragjyqeshëm sa i përket përputhshmërisë me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Për këtë arsye, një përpunim eventual i të dhënave nëpërmjet rubrikës në fjalë, sipas të gjitha gjasave, do të rezultonte në kundërshtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale (nenet 5, 6 dhe 18 të Ligjit). Për këtë arsye, duhet të ndalet përdorimi i tij *a priori* (pa marrë masat e nevojshme për informimin dhe marrjen e pëlqimit të subjektit të të dhënave);

5. Zyra e Komisionerit konstaton mangësi në nivel njohurish dhe masash tekniko-organizative për të garantuar një përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave personale, qoftë në kuadër të nevojave organizative të PSSH, qoftë në kuadër të fushatave elektorale.

Kontrolluesi, si dhe çdo organizim tjetër politik, nuk është i përjashtuar nga rregullat dhe detyrimet e parashikuara nga dispozitat e Ligjit dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij;

6. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Grupi i kontrollit konstaton mosplotësim të detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit së sigurisë së informacionit (SMSI) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuara nga Udhëzimi nr. 47, datë 14.09.2018 *“Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”* (në vijim, *“Udhëzimi nr. 47”*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi, është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47.

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të bazohet në standardin ISO/IEC 27001, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, datë 14.09.2018, të Komisionerit *“Për certifikimin e sistemeve të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre”* (në vijim, *“Udhëzimi nr. 48”*), si dhe është një sistem i certifikueshëm, për qëllime përputhshmërie me standardin e sipërpërmendur, vetëm nga organizma të akredituar dhe autorizuar sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48;

Ekzistenca e SMSI, me të gjithë elementët e saj (përfshirë, por pa u kufizuar, vlerësimin e ndikimit në privatësi, politikat e sigurisë së informacionit e të tjerë) përveç përmbushjes së një detyrimi formal-ligjor, përbën një garanci të arsyeshme për shmangien dhe/ose për restaurimin e situatave të rrjedhjes së të dhënave (*data breach*), siç mund të jetë rasti i qarkullimit të paligjshëm të të dhënave të anëtarëve të PSSH në Bazën e të Dhënave objekt hetimi administrativ.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve, si dhe ankesave të paraqitura ndaj Kontrolluesit, në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87 - 89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Kontrolluesi u paraqit në seancë dhe, pasi u njoh me çështjet e ngritura nga Zyra e Komisionerit (lidhur me ankesat për përpunim të dhënash nga ky Kontrollues), ka disponuar me shkrim në lidhje me to.

Nga përgjigjet e pyetjeve të parashtruara nga Zyra e Komisionerit, konstatohet se, nga të gjithë ankuesit, subjektet e të dhënave K.K. dhe Q.H. rezultojnë të jenë anëtarë të PSSH.

Sipas PSSH, subjektet në fjalë rezultojnë të kenë plotësuar formularin e anëtarit të partisë dhe të kenë dhënë të dhënat personale me vullnetin e tyre të lirë, në përputhje me rregullat e brendshme të organizatës në fjalë, si dhe dispozitat e Ligjit.

Më tej, kontrolluesi ka disponuar si vijon:

“Sipas Kodit Zgjedhor neni 60 “Vënia e listave të zgjedhësve dhe ekstraktit të përbërësve zgjedhorë në dispozicion të subjekteve zgjedhore dhe publikut”, për zgjedhjet e përgjithëshme dhe vendore, në prag të fushatave elektorale subjekteve politike u vihen në dispozicion listat e zgjedhësve për çdo QV, për saktësimin e verifikimin e tyre në terren, sipas QV dhe bashkive dhe më pas këto lista nuk janë objekt ruajtje ose përpunimi nga ana jonë si subjekt politik”.

Në lidhje me këtë pohim, Zyra e Komisionerit rikonfirmon sa konstatohet në Relacionin e Hetimit Administrativ sa i përket përbërësve elektorale, të cilat janë të dhëna që DPGJC vë në dispozicion të subjekteve zgjedhore në përputhje me nenin 60 të Kodit Zgjedhor.

Nga ana tjetër, në lidhje me pohimin se “[...] këto lista nuk janë objekt ruajtje ose përpunimi nga ana jonë si subjekt politik”, Zyra e Komisionerit thekson se PSSH, në cilësinë kontrolluesit, bart përgjegjësi për çdo veprimtari përpunimi të dhënash të kryer nga kjo organizatë në përmbushje të objektit dhe qëllimit të saj si person juridik.

Kontrolluesi, si dhe çdo organizim tjetër politik, nuk është i përjashtuar nga rregullat dhe detyrimet e parashikuara nga dispozitat e Ligjit dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij.

Zyra e Komisionerit vlerëson gatishmërinë dhe bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e hetimit administrativ, si dhe angazhimin serioz të tij për të rikuperuar mangësitë e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe eviton mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 7, 18, 20, 21, 27, 28, 29, 30, 31 (pika 1, germa “a/1”), si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi të ketë në vëmendje të vazhdueshme përpunimin e të dhënave personale në përputhje me dispozitat e Ligjit, si dhe të marrë masa për adresimin e konstatimeve të Komisionerit sipas pikave 1.5 dhe 1.6 të Pjesës 1 të Relacionit të Hetimit Administrativ.

Për këtë arsye, Kontrolluesi duhet:

- (i) të ndërmarrë nisma për përmirësimin e njohurive ligjore dhe teknike për adresimin e kërkesave të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, ndër të tjera, nëpërmjet trajnimit të punonjësve që kanë akses në të dhënat personale dhe mbikëqyrin proceset përpunuese dhe në drejtim të konsolidimit të praktikave dhe legjislacionit specifik që rregullon veprimtarinë e tyre;
- (ii) të marrë masa për identifikimin dhe gjurmimin e aksesit në të dhënat që përpunon në përmbushje të qëllimit të saj si organizatë politike, si dhe sigurojë shkatërrimin/fshirjen e pakthyeshme të të dhënave të përpunuara, në përfundim të qëllimit të përpunimit të tyre, duke siguruar mospërpunimin e tyre në tejkalim të kohës së nevojshme për përmbushjen e këtij qëllimi.
- (iii) në kuadër të germës (ii) më sipër, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47 – në harmoni me nenet 27 dhe 28 të Ligjit, sa i përket krijimit, mirëmbajtjes dhe administrimit të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale (përfshirë, por pa u kufizuar, sa parashtrohet në germat (i) deri (ix) të pikës 1.6 të Pjesës 1 të Relacionit të Hetimit Administrativ).

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të krijohet në përputhje me standardin ISO/IEC 270001, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, si dhe mund të certifikohet, për qëllime përputhshmërie me standardin në fjalë, nga organizma të akredituar dhe autorizuar në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi. Në këtë rast, Kontrolluesi, në zbatim të germës “b” të pikës 42 të Udhëzimit nr. 47, depoziton pranë Zyrës së Komisionerit një kopje të certifikatës së përputhshmërisë;

- (iv) të ndalojë përdorimin *a priori* të rubrikës ‘*Rekomando shokun tënd*’ (të aksesueshme në faqen e internetit www.ps.al), deri në marrjen e masave të nevojshme për të siguruar dhe garantuar informimin e subjekteve të të dhënave në përputhje me nenin 18 të ligjit, si dhe marrjen e pëlqimit të subjekteve të të dhënave për këtë përpunim, në përputhje me germën “a” të pikës 1 të nenit 6 të Ligjit;
2. Përveç sa rekomandohet shprehimisht në pikën 1 më sipër. Kontrolluesi duhet të adresojë të gjitha rekomandimet e tjera, që i drejtohen specifikisht atij, sipas pikave 1.5 dhe 1.6 të Pjesës 1, si dhe Pjesës 2, të Relacionit të Hetimit Administrativ;
 3. Në zbatim të pikës 1, të nenit 32, të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:

- (i) Në vazhdimësi, detyrimet e parashikuara në germat (i) deri (iii) të pikës 1, si dhe detyrimet e parashikuara në pikën 2, më sipër;
 - (ii) Menjëherë, detyrimin e parashikuar në germën (iv) të pikës 1, më sipër.
4. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra.

Ky Rekomandim u shpall sot, më datë 19.8.2021

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

